

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. D. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamentit të Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2105/2015 të datës 29.10.2015 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Beqë Shala dhe të akuzuarit, me datë 18.08.2016 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F. D. nga i ati S. dhe e ëma A. e lindur B., i lindur më datë “data e lindjes..” në Prizren ku edhe tani jeton rruga “.” nr. .. , ka të kryer shkollën fillore, automekanik – tani pa punë, i martuar baba i pesë fëmijëve, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 25.06.2015 rreth orës 22:25 minuta, në Prizren rrugën ” e drejton automjetin e markës “Alfa Romeo” me targa të regjistrimit italian .. – – .. , në kundërshtim me nenin 54 par.1 dhe 142 par.1 të LSKRR, në kuptim të cilit ngasësi duhet të ketë kujdes ndaj pjesëmarrësve tjerë në rrugë, nuk ia përshtat shpejtësinë e lëvizjes në rrugë dhe nuk kushton kujdes në zonat e banuara ku këmbësorët mund të shfrytëzojnë tërë rrugën dhe gëzojnë drejtën e përparësi para mjetit, bënë lëshimin teknik dhe kontribuon që të vije deri te aksidenti, ashtu që me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit e godet këmbësorin – të dëmtuarin A. Sh. , i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur në skaj krahit të djathtë të rrugës drejtimi i njëjtë me lëvizjen e automjetit, i shkaktuar lëndime trupore dhe atë: ndrydhje në kokë me gërvishtje, ndrydhje në kraharor dhe thyerjen serike e brinjëve në anën e djathtë të kockës së pelvikut, të cilat kanë karakterin e lëndimit të rëndë trupor.

Kësodore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 378 par.8 lidhur me par.6 të KPK i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2 (dy) vitesh nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari A. (E.) Sh. nga Prizreni rruga “.” nr. .. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të ekspertizës për ekspertin e komunikacionit shumën prej 40.88 €, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë shumen prej 20 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2105/2015 të datës 29.10.2015, kundër të akzuarit F. D. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akzuarit. I akuzuari nuk e kundërshtoj provat materiale në të cilat mbështetet aktakuza dhe e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 25.06.2015 në ora 22:25 minuta, në Prizren rrugën “..... ..”, i akuzuari F. D. duke e drejtuar automjetin e markës “ ” me targa të regjistrimit italian .. – – .. , kur arrin në vendin kritik e shkel ligjin mbi trafikun publik dhe vepron në kundërshtim me nenin 54 par.1 dhe 142 par.1 të LSKRR, nga pakujdesia e rrezikon trafikun publik aq sa e vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, gjatë vozitjes **nuk** ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes në rrugë dhe nuk kushton kujdes në zonat e banuara ku këmbësorët mund të shfrytëzojnë tërë rrugën dhe gëzojnë drejtën e përparësi para mjetit, bënë lëshimin teknik dhe kontribuon që të vije deri te aksidenti, ashtu që me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit e godet këmbësorin të dëmtuarin A. Sh. , i cili në momentin kritik lëvizte në skaj të krahut të djathtë të rrugës, në drejtim të njëjtë me lëvizjen e automjetit, ashtu që i shkaktoi lëndime trupore dhe atë: ndrydhje në kokë me gërvishje, ndrydhje në kraharor dhe thyerjen serike e brinjëve në anën e djathtë të kockës së pelvikut, të cilat kanë karakterin e lëndimit të rëndë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndet.

Gjykata para se të hap seancën fillestare – paraprakisht bëri shikimin e shkresave të lëndës dhe bëri analizën e provave materiale dhe atë: ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Inxh. A. O. të datës 05.09.2015, ekspertizën e ekspertit të mjeksisë ligjore Dr. M. G. të datës 08.10.2015, raportin mjeksor të Spitalit Rajonal në Prizren – Qendrës Emergjente të datës 25.06.2015, skicën e vendit të ngjarjes dhe fotodokumentacionin, me ç’rast është vërtetuar se provat janë marrë në pajtim me dispozitat e kodit të procedurës penale dhe aktakuzën e prokurorit të shtetit e bëjnë të qëndrueshme dhe e bazuar në ligj. Provat në fjalë me kohë janë parashtruar të akzuarit me qëllim që të njëjtat të kundërshtoj dhe të parashtrorj prova tjera të cilët do të shkojnë në favor të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe mbrojtjes së tij. Mirëpo në seancën fillestare pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i akuzuari deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat në të cilat mbështete aktakuza dhe e pranoi fajësinë për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPK. Prandaj pasi që i akuzuari në seancën fillestare pranoi fajësinë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, e cila mbështet në fakte dhe prova materiale, të cilat prova i akuzuari asnjëherë nuk i ka kundërshtuar, gjykata konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 246 të KPPK dhe

ka ardhur në përfundim se në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e genësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpalli fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunimi me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi i tij për kryerjen e veprës penale, gjendja materiale dhe statusore – është i gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i vetëm i familjes, kjo është hera e parë që bie ndesh me ligjin, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e morri konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1814/2015 të datës 18.08.2016

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.